



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

RAPORTI VJETOR 2021-2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

1. Misioni i Drejtorisë

Misioni i Drejtorisë Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (*DPMJ*) është kontributi ndaj kërkimit shkencor dhe inovacionit me qëllim rritjen e standardeve në arsimin e lartë konkurues dhe të njohura ndërkombëtarisht. Drejtoria është përgjegjëse për zbatimin e politikës së ndërkombëtarizimit të universitetit, duke operuar me efikasitet (*produktivitet, shpejtësi, cilësi dhe fleksibilitet*) ndaj ndryshimeve dhe kërkesës për inovacion në përputhje të plotë me sistemin e vlerave të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Drejtorija kontribuon përkundrejt:

- (i) vizionit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, i cili si institucion, synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë;
- (ii) misionit të tij për nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin në tërësi;
- (iii) objektivit të tretë të Planit të Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të universitetit, përmes pjesëmarrjes aktive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe nxitjen e partneriteteve, duke promovuar universitetin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- (iv) strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit.

2. Struktura

Drejtorija është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucional, në varësi të Rektorit dhe ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe ose/të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë¹.

Struktura e Drejtorisë përbëhet nga:

- a) Drejtori i Drejtorisë;
- b) Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve;
- c) Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë;

Organigrama e Drejtorisë si më poshtë vijon:

¹ Statuti i UAMD-së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË




Fig.1 - Organigrama e DPMJ-së

3. Funkcionet e Drejtorisë

Stafi i Drejtorisë kryen të gjitha shërbimet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj në drejtimin operativ, organizativ dhe financiar. Shërbimet e nevojshme sipas janë tërësia e masave me karakter operativ, organizativ, financiar, material, dhe të sigurisë fizike të institucionit sipas përcaktimeve në ligj.

Në përmbushje të funksioneve të saj, Drejtoria garanton dhe nuk duhet të jetë pjesë, në një proces që përbën gjendje konflikti interesi ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të punonjësit, në të cilën ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike, sipas referimeve të legjislacionit që rregullon parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

4. Veprimtaria

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazohet në këto parime:

a. Parimi i barazisë: të gjithë personat që marrin shërbimet e Drejtorisë trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, arsimit, etnisë, gjendjes ekonomike e sociale, bindjeve politike e fetare etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

b. Parimi i ligjshmërisë: të gjithë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre për përmbushjen e funksioneve të Drejtorisë, janë të detyruar të zbatojnë Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Askujt nuk i lejohet shmangia nga detyrimet, moszbatimi i ligjit apo zbatimi i gabuar i tyre, për shkak të padijenisë.

c. Parimi i vazhdimësisë: detyrat e ndjekura nga punonjësit e mëparshëm, që janë larguar nga detyra, do të vazhdojnë të realizohen nga punonjësit e rinj.

d. Parimi i transparencës: administrata e Drejtorisë, duhet të jetë sa më transparente në marrëdhëniet me studentët, stafin, partnerët, publikun, në të gjitha vendimet apo veprimet që ndërmerr.

e. Parimi i ndershmërisë: të gjithë punonjësit detyrohen të trajtojnë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjithë subjektet me të cilët hyjnë në marrëdhënie për shkak të detyrave apo kompetencave të tyre, duke zbatuar me rigorozitet parimet e etikës në administratë.

f. Parimi i bashkëpunimit: të gjithë punonjësit duhet të sigurojnë bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta sipas përcaktimeve të rregullores së brendshme të DPMJ-së.

5. Realizimi gjatë vitit akademik 2021-2022

Objektivat strategjikë:

1. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit, përmes organizimit dhe ofrimit të diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta me universitetet partnere përmes:

➤ *nënshkrimit të programeve të përbashkëta/dyfishta;*

UAMD është në komunikime të vazhdueshme me universitetet në vendet e BE-së në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve për diploma të përbashkëta/të dyfishta. Konkretisht, është në zhvillim bashkëpunimi dhe janë nënshkruar marrëveshjet me:

- Universitetin La Sapienza, Romë, Itali, për diplomë të dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve, Master Shkencor në “E drejtë europiane”;
- Universitetin e Genova-s, Itali për diplomë e dyfishtë në ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Shkenca ndërkombëtare dhe diplomaci”.

Ndërkohë, janë në zbatim marrëveshjet e mëposhtme:

- diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të studimeve, Doktoratë në “Shkenca edukimi” Universiteti Pedagogjik i Krakovit, Krakov, Poloni;
- diplomë e dyfishtë në ciklin e parë të studimeve, Bachelor në “Bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik” Universiteti La sapienza, Romë, Itali;
- diplomë e dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve, Master Shkencor në “Administrim publik” universiteti Côte d'Azur, Nicë, Francë.

UAMD është gjithashtu në komunikim me konferencën e Rektorëve në Spanjë si dhe universitetet në këtë vend, nisur edhe nga marrëveshja e mirëkuptimit nënshkruar midis qeverisë Shqiptare dhe asaj Spanjolle në këtë kuadër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- programeve që mbështesin shkëmbimet e stafit akademik dhe administrativ;
- programeve që mbështesin shkëmbimin e studentëve të cikleve të ndryshme të studimit për periudha semestrale studimi (ose më të gjata) ose për periudha të praktikave mësimore;

Në kuadër të programeve të shkëmbimit, UAMD ka nënshkruar 16 marrëveshje të reja ndër-institucionale këtë vit akademik nën programin Erasmus+, programi i shkëmbimeve si më poshtë vijon:

Nr.	Universiteti Partner
1	Universiteti i Split, Kroaci;
2	Universiteti Leonardo da Vinci, Francë
3	Universiteti i Seviljes, Spanjë
4	Universiteti i Leon, Spanjë
5	Universiteti HSSE Plovdiv, Bullgari
6	Universiteti Koblenz, Gjermani
7	Universiteti Tomas Bata, Çeki
8	Universiteti Yildiz Technical, Turqi
9	Universiteti "King Michael I of Romania", Rumani
10	Universiteti Sopot, Poloni
11	Universiteti A Coruna, Spanjë
12	Universiteti Rey Juan Carlos, Spanjë
13	Universiteti HWR Berlin, Gjermani
14	Universiteti "Luigi Vanvitelli", Itali
15	Universiteti "G. D'Annunzio", Itali
16	Universiteti Cadiz, Spanjë

Këtë vit, UAMD ka patur një rritje të ndjeshme të studentëve të cilët kanë përfituar nga shkëmbimet në universitetet partnere europiane.

Përgjatë vitit akademik 2021-2022 kanë duke përfituar nga bursë e plotë studimi 78 studentë në universitete të vendeve të BE-së, të cilët kanë përfituar nga një mbështetje financiare prej afërsisht 351.000EUR nën mbështetjen e këtij programi.

Sa i takon shkëmbimeve të stafit akademik, gjatë këtij viti, kanë përfunduar shkëmbimet 124 staf akademik dhe 21 staf administrativ të cilët kanë përfituar nga një mbështetje financiare prej afërsisht 182.000EUR nën mbështetjen e këtij programi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- *aktiviteteve dhe publikime të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor dhe /apo inovacionit;*
- *konferencave, seminareve, takimeve akademike, eventeve, shkollave verore etj., që nxisin rritjen e kapaciteteve si edhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies;*
- Publikim në web të njoftimit mbi Techstars Startup Weekend Balkans;
- Publikim të thirrjes për Bursat Erasmus Mundus në programin Master AMASE;
- Publikim të thirrjes për pjesëmarrje në Konferencën ndërkombëtare e hapur nga Universiteti Bielefeld Gjermani;
- Përgatitja e materialit mbi Universitetet Italiane në Rajonin e Lazios;
- Përgatitja e materialit mbi aplikimet Erasmus në gjuhën Italiane;
- Përgatitja e materialit mbi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me titull “Inteligjenca Artificiale në Fushën e Sigurisë – Përparësitë dhe Kërcënimet”;
- Përgatitja e materialit për publikim mbi bursat "Banach";
- Përgatitja e thirrjes së hapur për Konferencën e Migracionit nga IBU (International Burch University).
- *rritjes së numrit të studentëve të huaj që studjojnë në këtë universitet;*

Dy studentë nga Universiteti i Vigo, Spanjë, të nivelit Bachelor dhe Doktoraturë, janë akomoduar pranë Fakultetit të Biznesit.

- *ofrimit të programeve të studimit në gjuhën angleze.*

Fakultetet në UAMD, kanë ofruar aktivizimin e programeve të caktuara në gjuhën angleze nisur nga kërkesa e prezencës së studentëve të huaj. Aktualisht, programet që ofrohen në gjuhë angleze pranë çdo fakulteti, janë të publikuara në faqën zyrtare web të UAMD-së dhe është shtuar kërkesa nga ana e universiteteve partnere dhe studentëve të huaj për kurset në gjuhën angleze.

2. Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar;

UAMD është përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit dhe nxitjen e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar. Kjo strategji mbështet në tërësi zhvillimin e partneriteteve publik-privat, me komunitetin e biznesit, think tank, shoqëri civile dhe median. Një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Strategjia e ndërkombëtarizimit mbështet rivitalizimin, në nivel vertikal dhe horizontal, të marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit, si edhe nënshkrim të marrëveshjeve të reja me universitete brenda dhe jashtë vendit, kryesisht ato perëndimore, me grupet e interesit për të formalizuar apo institucionalizuar marrëdhënien, për të patur një ambient favorizues dhe stimulues për kërkimin shkencor dhe për të realizuar shkëmbime të stafit akademik dhe të studentëve. UAMD synon gjithashtu nënshkrimin e marrëveshjeve të reja dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit, zbatimin e tyre në praktikë, monitorimin e ecurisë së tyre, vlerësimin/matjen e progresit të arritur dhe impaktin potencial me mundësi përshkallëzimi të praktikave të mira në nivel kombëtar dhe më gjerë.

Për gjatë vitit akademik 2021-2022, janë nënshkruar 21 marrëveshje të reja dhe janë rinovuar dy



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

marrëveshje nga ato ekzistuese, si më poshtë vijon:

Marrëveshje të finalizuara gjatë vitit 2021-2022 në rang Ndërkombëtar	Marrëveshje të finalizuara gjatë vitit 2021-2022 në rang Kombëtar	Marrëveshje të rinovuara
1—Universiteti i Sarajevës, Bosnje Herzegovinë;	1 – Qendra kundër ekstremizmit të dhunshëm, Tiranë;	1- Universiteti "Haxhi Zeka", Kosovë;
2– Universiteti i Janinës Greqi;	2 – Enti Rregullator i Energjitikës, Tiranë;	2- Universiteti G.d'Annunzio, Itali.
3 – Universiteti Tbilisi Gjeorgji ;	3 – Komisioneri për mbrojtjen ndaj diskriminimit, Tiranë;	
4 – Universiteti Tiraspol State, Moldavi;	4- AADF, Tiranë;	
5 - Universiteti Teknik i Riga-s, Letoni;	5- Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe territoriale - ALTRI, Tiranë;	
6 - Alma Mater Campus, Kosovë;	6 -Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Vlorë.	
7- Instituti Diplomatik Ndërkombëtar, Romë, Itali;		
8 - Universiteti Ss.Cyryl, Maqedonia e Veriut;		
9 - Universiteti i Piemontes, Itali;		
10 - Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë, Kosovë;		
11 - Universiteti Masaryk, Çeki;		
12 - Universiteti Caucasus, Gjeorgji;		
13 - Universiteti Kombëtar Kharkiv, Ukrainë;		
14 - Universiteti Sousse Tunizi;		
15 - Universiteti i Camerinos, Itali.		

Fushat e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëpunimit janë:

Nxitja e bashkëpunimit për përmirësimin e punës në fusha të përbashkëta studimi dhe kërkimi, shkëmbime të botimeve akademike ose periodike, mundësia reciproke në përdorimin e bibliotekave për literaturë të pa klasifikuar, inkurajim i përdorimit të teksteve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- # Bashkëpunime në shërbim të studentëve për krijimin e mundësisë së praktikave mësimore për të integruar studimet akademike me përvojën e punës;
- # Bashkëpunim dhe shkëmbime në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor si Erasmus+;
- # Shkëmbim i materialeve dhe rezultateve të punës studimore e shkencore;
- # Shkëmbimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në aktivitete didaktike, në kuadër të shkëmbimit të përvojës shkëmbehen programe dhe plane mësimore për fushat me interes të përbashkët
- # Shkëmbim studentësh të cikleve të ndryshme studimi për periudha semestrale studimi ose për periudha praktike mësimore;
- # Shkëmbim i stafit akademik dhe administrativ;
- # Mbështetje të kërkimit shkencor të orientuar drejt praktikës;
- # Nxitja dhe motivimi për punime shkencore për kualifikimin dhe marrjen e titujve akademik;
- # Organizimi i konferencave të përbashkëta, trajnimeve, intershipëve, seminareve, praktikave mësimore, leksioneve të hapura kurseve specifike;
- # Organizim i shkollave verore për studentët;

Stafi i Drejtorisë ka ofruar mbështetje në realizimin e aktiviteteve të ndryshme, është angazhuar në shpërndarjen e informacionit për rritjen e kapaciteteve njerëzore përmes pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca publikime kombëtare e ndërkombëtare.

3. Rritja e numrit dhe cilësisë së zbatimit të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive;

UAMD është i angazhuar intensivisht në aplikimin dhe zbatimin e projekteve që lidhen me rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit për arsimin e lartë, projekte që targetojnë zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve pranë universiteteve të huaja, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht në bashkëpunim me stafin lokal, si dhe pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratorëve.

Sa i takon aplikimeve 2021-2022:

- ✚ me çeljen e fazës së re të programimit 2021-2027 nën programin Erasmus+, UAMD ka aplikuar këtë vit akademik në 15 projekte (WBUnis4MigMan; TRACE; IPC; SUBREG; WEBJOU; PELMOB; IoT-ECO; MAGNET; DIGICA; DISOTEK; SDE-RACB; O3S4YOUTH; ICTDual4Wbc; Zero-C; B-MARE);
- ✚ 4 aplikime në programin Horizon Europe (Magna; CSPAR4EuroDem; POETRY; ELEMENTS);
- ✚ 3 aplikime në kuadër të ndërkombëtarizimit, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- ✚ 1 aplikim nën programin EU4Culture;
- ✚ 2 aplikime nën programin Interreg;
- ✚ 1 aplikim nën programin Visegrad Fund;
- ✚ 4 aplikime në AKKSHI për projekte të kërkimit shkencor;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- ✚ 2 aplikime pranë AKKSHI (njëri bazuar në thirrjen e marrëveshjes bilaterale Shqipëri-Turqi dhe 1 bazuar në marrëveshjen Shqipëri-Austri);
- ✚ 1 aplikim pranë Ministrisë së Sipërmarrjes dhe Inovacionit.

Nga sa më lart dhe nga rezultatet e deritanishme, kanë rezultuar fitues:

- 4 projekte nën programin Erasmus+
 - *Kurse të arsimit të lartë në gazetari të të dhënave në vende të Ballkanit Perëndimor – (WEBJOU). Institucioni koordinator është Universiteti i Tuscias, Itali;*
 - *Përmirësimi i menaxhimit dhe qeverisjes përmes mësimdhënies (MAGNET). Institucioni koordinator është Universiteti Democritus Thrakisë, Greqi;*
 - *Partneritet për promovimin dhe popullarizimin e lëvizshmërisë Elektrike përmes transformimit dhe modernizimit të programeve të studimit të IAL-ve të vendeve të Ballkanit Perëndimor (PELMOB). Institucioni koordinator është Universiteti i Mitrovicës, Kosovë;*
 - *Transformimi i gjelbër përmes teknologjisë Internet of Things (IoT) për shoqërinë akademike dhe ekosistemin e orientuar drejt biznesit në Ballkanin Për shoqërinë akademike dhe ekosistemin e orientuar drejt biznesit në Ballkanin Perëndimor (IoT-ECO). Institucioni koordinator është Universiteti Teknik i Sofjes, Bullgari.*
- 1 projekt nën programin Interreg (CRESCENDO);
- 1 projekt i financuar nga AKKSHI përmes fondeve të kërkimit shkencor (*Përgatitja, pilotimi dhe aftësimi i aktorëve vendorë mbi zbatimin e Metodologjisë për vlerësimin e Ndikimit Barazisë Gjinore dhe rekomandimet e OBP-së [ILO] për Punën e Denjë në Shqipëri*);
- 3 projekte të financuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, konkretisht:
 - ✚ *Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të studimeve, doktoratë në “Shkenca Edukimi” Universiteti Pedagogjik Krakov, Poloni.*
 - ✚ *Diplomë e dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve, master shkencor në “Administrim Publik” Universiteti Côte d'azur, Nicë, Francë.*
 - ✚ *Diplomë e dyfishtë në ciklin e parë të studimeve, bachelor në “Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik”, Universiteti La Sapienza, Romë, Itali.*
- 1 projekt i financuar nga AKKSHI nën marrëveshjen bilaterale Shqipëri-Austri me titull “Matjet e transportit makroplastik në lumin Ishëm, lumi më i ndotur në Evropë (MaPIshem)”.

Drejtorja, që prej muajit maj 2022, është angazhuar në mbështetje të procesit të aplikimeve për projekte kërkimore-shkencore bazuar në fondin e brendshëm institucional për kërkim shkencor, që prej shpalljes së thirrjes, mbledhjes së aplikimeve, procesit të vlerësimit, shpalljes së fituesve dhe nënshkrimit të kontratave sipas të dhënave më poshtë:

Projekte fituese që parashikohet të financohen me buxhetin e vitit 2022

Nr. Titull projekti

E- Qeverisja – Digjitalizimi i sektorit publik dhe shërbimeve publike

1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- 2 Rritja e qëndrueshme e mirëqenies përmes sipërmarrjeve të reja sociale: Konkurs dhe dokument politikash për fizibilitetin e qasjes
- 3 Impakti i mediave sociale dhe zhvillimit teknologjik në aplikimin e programeve të besnikërisë konsumatore. Rasti i tregut të shërbimeve në Shqipëri.
- 4 ResCLIN – Forcimi i kapaciteteve të funksionimit të Klinikës së Ligjit përmes kërkimit shkencor
- 5 Ankthi profesional dhe ndikimi i tij në mësimdhënie
- 6 Sfidat dhe praktikatat që sjellin fuqizimin e grave në sipërmarrje dhe vendim-marrje politike: rast studimor i rajonit të Durrësit dhe Tiranës
- 7 Vlerësim i turizmit dhe siteve turistike në qytetet Berat, Përmet, Kolonjë ndaj inovacionit drejt turizmit të eksperiencave
- 8 Dizenjimi dhe Implementimi i Databazës së Aluminit për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës
- 9 Fuqizimi i performancës së mësuesit të arsimit fillor midis dilemave dhe tendencave post-covid-19
- 10 Zbatimi i Strategjisë së re të BE-së për ushqimin në zinxhirin ushqimor në Republikën e Shqipërisë
- 11 Krijimi i Manualit për zhvillimin e praktikës profesionale për studentët e Fakultetit të Edukimit, cikli i parë dhe i dytë i studimeve
- 12 Kërkim mbi vlerësimin e Programeve të studimit në Fakultetin e Edukimit UAMD (Programet e edukimit fillestar të mësuesve të Arsimit Fillor (BA/MA) dhe Arsimit Parashkollor)
- 13 Sfidat e politikave publike në administratën publike shqiptare
- 14 Siguria kibernetike në transportin detar, element kyç për zbatimin e aktiviteteve detare portuale të sigurta dhe inovative
- 15 Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien
- 16 MCDA- Grupi i Analizës së Vendimit: Studim, Analizë dhe Ndihmesë në Vendimarrje në aktivitete të ndryshme ekonomike dhe probleme lokale dhe kombëtare

Projekte fituese që parashikohet të financohen me buxhetin e vitit 2023

- 17 Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në gjetjen e burimeve të reja të financimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Procesi i Integritimit Evropian dhe roli i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

18

19 Qytetari e angazhuar në Bashkinë Durrës për shërbimin "Administrim të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"

20

Ulja e Borxhit publik, nga legjislacioni i zbatueshëm me strategjinë afatmesme të menaxhimit të riskut (SAMB / AFMIS)

21

Aftësimi i studentëve doktoral në metodat e kërkimit në biznes (Business research)

22

Përforcimi i legjislacionit të MFK-së, përmes shtimit të kontrollit të brendshëm të menaxhimit financiar e kontrollit (KR)

Ndërkohë, ka vijuar procesi për zbatimin dhe ndjekjen e projekteve që po zbatohen aktualisht në UAMD konkretisht për projektet: ENTRAL, QUADIC, KALCEA, STAND, IDEA, ENGINE, U-SIA, MEPM, TTO4FOOD, Value- X, ku UAMD është institucion partner dhe V-TECH ku UAMD është lider.

Si një ndër kërkesat e detyrueshme për aplikimet nën programin Horizon Europe, Drejtoria ka lehtësuar procesin e hartimit të planit të barazisë gjinore (Gender Plan) i cili është publikuar në faqen web zyrtare të UAMD.

4. Zhvillimi dhe forcimi i strukturave primare dhe atyre mbështetëse, për ndërkombëtarizimin e institucionit;

Në kuadër të ndërkombëtarizimit, më datë 29 Shtator, në orën 10:00 u organizua aktiviteti i çeljes së projekteve të diplomave të dyfishta me institucione të arsimit të lartë të vendeve të BE-së. E ftuar ishte edhe Zv. Ministria e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Znj. Albana Tole e cila diskutoi mbi planin e veprimit të strategjisë si edhe mbështjen që ofron MAS drejt ndërkombëtarizimit të Insitucioneve të arsimit të lartë. Nga universitetet partnere të ftuar ishin Prof. Christian Vallar, Ish-Dekan dhe Profesor i së Drejtës në Universitetin Côte d'Azur (online), Prof. Marco Cilento nga Departamenti i komunikimit dhe kërkimit social në Universitetit La Sapienza si edhe Dr. Kinga Orzeł-Dereń, përfaqësuese e Institutit të Arsimit parashkollor dhe fillor në Universitetin Pedagogjik të Krakovit. Ata diskutuan mbi rrugëtimin e marrëdhënieve dypalëshe, shkëmbimet dhe bashkëpunimin në kuadër të ndërkombëtarizimit, si edhe në lidhje me hapat vijues të procesit të realizimit të hapjes së programit bachelor, master dhe doktoratë.

Në kuadër të projektit VITECH u inagurua laboratorit Virtual Technology and Innovation në mjediset e UAMD-së.

Drejtoria, gjithashtu ka qenë pjesëmarrëse në ditët e organizuara nën programin Erasmus+ duke shpallur fondet e përfutuara në kuadër të projekteve dhe shkëmbimeve. Drejtoria gjithashtu ishte pjesëmarrëse në seminarin e organizuar me universitetet franceze dhe universitetet e vendeve të Ballkanit Perëndimor më 22 dhe 23 Nëntor 2022 në Tiranë. Seminari u organizua në kuadër të programit Erasmus + për të eksploruar mundësinë e bashkëpunimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

5. Rritja e vizibilitetit të universitetit, përmes rrjetëzimit në rrjetet universitare në rajonin e Ballkanit perëndimor, rajonit të mesdheut dhe vendeve anëtare të OSCE-së.

UAMD synon të jetë i pranishëm aktivisht në aktivitete ndërkombëtare shkencore dhe botuese. Si rezultat i kontakteve të krijuara nga lëvizjet e studentëve e akademikëve dhe nga përafrimi i kurrikulave, i cili është i nevojshëm në rastin e shkëmbimit të studentëve, stafet akademike do të mund të rrisin kapacitetet lidhur me edukimin që ofrohet në UAMD. Këto aktivitete do të kontribuojnë në përshtatjen dhe përhapjen e “praktikave të mira” si edhe në cilësinë e edukimit dhe të trajnimit.

Drejtoria ka mbajtur komunikime të vazhdueshme dhe ka qënë pjesëmarrëse aktive në aktivitetet e rrjeteve ku është anëtare si UNIMED, AUF, OARI etj.,

Këtë vit, është aplikuar për antarësimin e UAMD pranë Organizatës Europiane të Universiteteve - European University Association (EUA) dhe jëmi në pritje të antarësimin.

Gjithashtu, në kuadër të hapjes së thirrjes për aplikime nën programin Erasmus+ komponenti i Partneritetit për Ekselencë – Universitetet Europiane, ka punuar intensivisht për të qënë pjesëmarrëse në këtë aplikim përmes rrjetit STARS EU Alliance. Ky rrjet, ka ftuar UAMD për të qënë partner në aplikimin e thirrjes së Universiteteve Europiane. Si rrjedhim i angazhimeve në këtë rrjet, deri më tani janë ngritur disa struktura ku UAMD është anëtare me të drejta të plota si Komisioni i Aleancës STARS EU; Komiteti Drejtues; Grupet Tematike të Interesit etj.,

Anëtarët e rrjetit, janë universitetet si më poshtë vijon:

1. Universiteti i Shkencave të Aplikuara Hanze, Hollandë;
2. Instituti Politechnik i Bragances, Portugali;
3. Universiteti teknologjik i Krakovit, Poloni;
4. Universiteti Silesian në Opava, Ceki;
5. Universiteti La Laguna, Spanjë;
6. Universiteti Ëest, Suedi;
7. Hochschule Bremen; Gjermani;
8. Universiteti Franche-Comte, Francë.

Drejtoria sëbashku me stafin akademik është e angazhuar në zhvillimin e projekt propozimit të aleancës si edhe të aplikimit për Erasmus Charter for Higher Education, i cili është i domosdoshëm për të qënë pjesë e Aleancës.

Ndërkohë, pritet që shumë shpejt të nënshkruhen marrëveshjet ndër institucionale në kuadër të programit Erasmus+, komponenti i shkëmbimeve, me të gjithë anëtarët e kësaj Aleance.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Fig.1. Studentët e UAMD në ditën kulturore në universitetet partnere



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Fig. 2 Shpërndarja e Certifikatave të studentëve përfitues të shkëmbimeve Erasmus+



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Fig.3 Studentët e huaj Erasmus+ në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Bielefeld, Gjermani.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Fig. 4 Ditët informuese Erasmus+